

AKT THEMELIM
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
'Entrepreneur' shpk
date
23.01.2020

Ne perputhje me ligjin nr. Nr.990!, date 14.4.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Ligjin nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kornbetare te Biznesit, Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijohet shoqeria tregtare, me pergjegjesi te kufizuar, me emertimin **'Entrepreneur'**

KREUi

Neni 1
Emertimi

Shoqeria dote emertohet "Entrepreneur" shpk dhe eshte personjuridik i te drejtes shqiptare.

Neni 2
Personaliteti iuridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKB, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.
Shoqeria "Entrepreneur" shpk eshte nje shoqeri tregtare, e themeluar nga ortaku i vetem, i cili nuk pergjigjet per detyrimet e shoqerise tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara, Kontributi i ortakut perben kapitalin e regjistruar te shoqerise.

Neni 3
Selia

Shoqeria e ka seline ne adresen: Rruga "Mikelanxho", Lagjia nr 13, Durres.
Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Ortakut te Vetem.

Neni 4
Objeti i veprimtarise

Import-eksport te materialeve te ndryshme me shumice e pakice e shkembimeve tregetare nga Shqiperia per jashte dhe ngajashte per ne Shqiperi etj.

Neni 5
Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga

data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

KREU II KAP/TALI

Neni 6 Kapitali theme/tar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,000 leke
Kapitali i mesiperm eshte nenshkruar nga "ortaku i veteri" i shoqise:

z.Bajram Molla, zoterues i 1 (nje) kuote, me viere te pergjithshme 100,000 leke, qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfakesohen nga letra me vlore te tregtueshme.
Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta).
Ortaku per gjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise; Kapitali i shoqerise dote hidhet ne Banke pasi te dali NIPT-i i shoqerise.

Neni 7 Transferimi I kapitalit

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- 9) dhurimit;
- d) cdo rnenyre tjeter te parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalirnit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate per gjigjen ne rnenyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga casti i kalimit te kuotave, deri ne castin e regjistrimit te kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit, sipas nenit 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kornbetare te Biznesit". Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Ortaku i Vetern eshte organi i vetem vendimnarres i shoqerise.

Ortaku i Vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe rnriraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Ortaku i vetem, vendos per ceshtje si:

- a) percaktirni i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) ernerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- y) percaktimin e shperblimeve;
- d) mbikeqyrjen e zbatirnit te politikave tregtare nga admrinistratoret, perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asarnblese;

Te gjitha vendimet e marra nga ortaku i veteri regjistrohen ne nje register te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhen regjistruar ne vecanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- y) vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendirneve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesirn, pervec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqerise eshte znj.Manushaqe Malaj, atesia Zenel, e datelindjes 17/05/1957, lindur ne Durres, shtetase Shqiptare, madhere, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, mbajtese e leternjoftimit te shtetit Shqiptar me nr.F75717025V, emeruar ne kete detyre per nje afat 5 vjecar mete drejte riperteritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem te shoqerise.

Neni J0

Kompetencat

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- a) kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprirtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asarnbleja e perqjithshme;
- b) perfaqesoje shoqerine tregtare;
- c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- c) perqatisi dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se

- veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin kero dokumente perpara asamblese se per gjithshme per miratim;
- d) krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rr Ethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- dh) kryeje regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic; parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- e) raportoje perpara asamblese se per gjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;

Administratori eshte i detyruar te therrasi mbledhjen e ortakut te vetem edhe ne rastet kur: sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrirnet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim dhe kur shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve re shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara,

Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtezakonshern. Administratori perfaqeson Shoqerine perpara te gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoritetete shteterore Shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te gjitha shkallev. Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rr Ethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.

Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo proven se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objek:tin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rr Ethanat e dhena, duke patur parasysh fak:tin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e rnjaftueshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 12

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohe zgj atja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) me vendim te ortakut te vetem;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- c) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me pikën 3 te nenit 43 te ligjt nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- d) me vendim te gjykates;

Ne kete rast Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar I apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij

ernrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Nenil3

Baza Ligjore

Shoqeria dote zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit Shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, dote zbatohen dispozirat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 14

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemlare ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera te njeja juridike.

Akti i mesiperrn pasi miratohet ne parirn dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise tregtare Entrepreneur" shpk nenshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

ORTAKU I VETEM

Bajram MOLLA

Bajram Molla
[Signature]